



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë C (3) (Anglisht)

Ngarkesa: 4 kredite, 40 seminare
Viti / Semestri: Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhën Angleze
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva te përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon t'u ofrojë studentëve njohuri të shumfishta të gjuhës angleze për ta përdorur atë si mjet komunikimi në jetën e përditshme dhe në ambiente të ndryshme ku mund të paraqitet nevoja e komunikimit me këtë gjuhë.

Objektivat specifike lëndore: Në përfundim të këtij kursi studentët do jenë të aftë të

1. Të pyesin dhe të përgjigjen në gjuhën angleze për tema të ndryshme të jetës së përditshme.
2. Të komunikojnë me folës të tjerë të gjuhës angleze pa pasur probleme të të kuptuarit.
3. Të diskutojnë për tema të ndryshme që ofrohen në libër por edhe nga vetë studentët.

Rezultatet e pritshme:

1. Përdorimi i gjuhës së folur dhe të shkruar – Studentët do të jenë të aftë të përdorin gjuhën angleze për të komunikuar lirshëm në situata të përditshme, si dhe të shkruajnë tekste të thjeshta dhe dokumente të natyrave të ndryshme.
 2. Zhvillimi i aftësive të leximit dhe të kuptimit – Studentët do të lexojnë dhe interpretojnë me kuptim tekste të ndryshme në anglisht dhe do të jenë në gjendje të përpunojnë informacionin e përfituar në mënyrë efektive.
- Aftësi për ndërveprim dhe diskutim – Studentët do të jenë të aftë të zhvillojnë biseda dhe diskutime në anglisht mbi tema të ndryshme, duke përdorur fjalor të përshtatshëm dhe struktura gjuhësore të nivelit përkatës.